

E SHKËRITUR

19.09.2019

MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTARSTVO PRAVE  
MINISTRY OF JUSTICE

Mënyrë Regjimore: 2415 / 18.10.12

Prishtëria



Shërbimi Korrektues i Kosovës

Regjimet për të denuar

## PËRMBAJTJA

Misioni i Shërbimit Korrektues të Kosovës .....	2
I. Qëllimi .....	2
II. Baza Ligjore .....	2
III. Përkufizimet .....	2
IV. Regjimet .....	2
V. Vendosja e personave të dënuar në institucionet korrektuese .....	3
VI. Planifikimi i dënimit .....	3
VII. Llojet e Regjimeve (Tretmanëve) .....	4
a. Regjimi i Pranimiit .....	5
b. Regjimi Themelor .....	7
c. Regjimi Standard .....	7
d. Regjimi i Avancuar .....	8
e. Regjimi Gjysmë i Hapur .....	9
f. Regjimi i Hapur .....	11
VIII. Regjimet Specifike .....	
a. Regjimi për të Burgosurit me Rrezikshmëri të Lartë.....	12
b. Regjimi i Ndarjes .....	12
c. Regjimi i Vetmisë .....	13
d. Regjimi për Femrat shtatzënë, dhe ato me fëmijë .....	14
e. Regjimi për Dëshmitarët e Mbrojtur .....	15
f. Regjimi për të Paraburgosurit .....	15
g. Regjimi për të Miturit .....	15
IX. Mënyra e Implementimit të Regjimit .....	
a. Ulja e Regjimit .....	16
X. Aktivitetet në Regjime .....	17
a. Arsimi .....	17
b. Puna .....	18
c. Kontakti me botën e jashtme .....	18
d. Aktivitetet religjioze .....	19
e. Terapia okupuese .....	19
f. Terapia individuale dhe grupore .....	19
g. Edukimi fizik dhe sporti .....	19
h. Aktivitetet e lira kreative dhe hobit .....	19
i. Lojërat dirigjuese .....	19
j. Aktivitetet jashtë institucionit në komunitet, pushimet ditore dhe format tjera të Pushimit .....	19
k. Përgatitja për lirim dhe përkujdesja pas lirimit .....	20

## MISIONI I SHËRBIMIT KORREKTUES I KOSOVËS

Shërbimi Korrektues i Kosovës në bashkëpunim me të gjithë partnerët e Drejtësisë Penale dhe në përshtatshmëri të vazhdueshme me ligjet e aplikueshme në Kosovë synon të korrektoj dhe ri socializoj të burgosurit, duke respektuar të drejtat e tyre fundamentale pa marrë parasysh racën, gjuhën, religjionin si dhe të sigurojë ambient të sigurt për stafin, të burgosurit dhe shoqërinë.

### I. QËLLIMI

1. Ky dokument ka të bëjë me regjimet për të dënuarit, si për meshkuj ashtu edhe për femra, të cilët janë dënuar me burgim dhe me burgim afatgjatë.
2. Qëllimi i këtij dokumenti është të qartësojë parimet në bazë të cilave zyrtarët duhet të operojnë me regjime, tiparet kryesore dhe çfarë ata duhet të arrijnë.

### II. BAZA LIGJORE

1. Ligji mbi Ekzekutimin e Sankcioneve Penale
2. Kodi i Drejtësisë për të Mitur ,///

### III. PËRKUFIZIMET

Shprehjet e përdorura në këtë dokument kanë këto kuptime:

1. Termi Regjim (Tretman): nënkupton organizimin e jetës së përditshme të të burgosurve duke përfshirë shumë aktivitete arsimore, edukuese, sociale dhe privilegje në bazë të nevojave të tyre, sjelljes dhe sigurisë.
2. "Person i dënuar" nënkupton personin i cili është dënuar me aktgjykim të formës së prerë nga gjykata kompetente;
3. "Institucion Korrektues" nënkupton Burgun dhe Qendrën Korrektuese, përderisa të jetë e cekur decidivisht.
4. "Ekipi multidisiplinar" nënkupton ekipin e Institucionit Korrektues që përbëhet nga profesionist të fushave të ndryshme i angazhuar në rehabilitimin dhe risocializimin e personave të dënuar.

### IV. REGJIMET

1. Regjimet hartohen për t'iu mundësuar të dënuarve që të bëjnë një jetë të përgjegjshme dhe pa shkelje të ligjit.

2. Qëllimi i regjimeve është që çdo nivel i tyre të ofrojë një program të balancuar aktivitetesh në mënyrë që, të burgosurit të kalojnë sa më shumë kohë në ditë jashtë dhomave të tyre sipas nevojë për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror.

3. Vëmendje e veçantë do t'iu kushtohet nevojave të të dënuarve që kanë qenë objekt të abuzit fizik, mendor dhe seksual.

#### V. VENDOSJA E PERSONAVE TË DËNUAR NË INSTITUCIONET KORREKTUESE

1. Gjatë vendosjes së personit të dënuar në institucionin e veçantë korrektues ose në njësi veçanta të institucionit korrektues duhet të merren parasysh: mosha e tij, llojet dhe pesha e dënimit, dënimet e mëparshme (nëse ka pasur), shëndeti fizik dhe mendor, preferencën e tij/s rekomandimet prej autoriteteve relevante për trajtim të veçantë, lokacioni i vendqëndrimit /vendbanimit të familjes së tij, siguria, si dhe arsyet lidhur me arsimimin ose punën që mund të jenë të rëndësishme për ri integrimin e tij shoqëror.

2. Po ashtu duhet të merret parasysh mundësia për zbatimin e programeve të përbashkë riedukuese si dhe nevoja për shmangien e ndikimeve negative.

3. Personat e dënuar meshkuj dhe femra vendosen ndarazi. Gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë të tyre vendosen ndarazi nga gratë e tjera të dënuara.

4. Personat e dënuar nuk vendosen në të njëjtën pjesë të Institucionit me personat e paraburgosur.

5. Duhet bërë përpjekje që personat e dënuar për herë të parë të ndahen nga personat të cilët për herë të parë kanë mbajtur dënimin me burgim (recidivistët).

6. Edhe shtetasit e huaj duhet të trajtohen të barabartë, duhet bërë çdo përpjekje për t'iu dhënë atyre mundësi për të marrë pjesë në aktivitetet e regjimit në mënyrë të përbashkët, me qëllim t'iu lehtësohet mbajtja e dënimit.

7. Të burgosurit me sëmundje mentale nuk duhet të mbahen në burg. Të burgosurve me sëmundje mentale duhet t'iu ofrohet përkujdesje apo trajtim i veçantë në burg apo në institucione specializuara të shëndetit mental. Andaj, ata duhet të ndahen nga pjesa tjetër e popullatës dhe mbahen nën mbikëqyrje të shtuar.

8. Të burgosurit konsultohen, për aq sa është e mundur, për vendosjen fillestare dhe për transferime të mëvonshme nga njëri institucion në tjetrin.

#### VI. PLANIFIKIMI I DËNIMIT – PLANI INDIVIDUAL


1. Planifikimi i Dënimit, që nënkupton planin individual për të burgosurit e dënuar, përfshinë varg aktivitetesh kuptimplota dhe intervenime në bazë të nevojave të tyre dhe rrezikshmërisë, përgatitjen e tyre për lirim dhe re integrim në shoqëri.

2. Plani ka për qëllim progresin në lëvizjen e të dënuarve nga regjimet me kushtet më kufizues ato me më pak kufizime, ideale faza përfundimtare të kalohet në kushte të hapura, mundësi të komunitet.

3. Planifikimi i dënimit bëhet për të gjithë të dënuarit me më shumë se 1 vit dënim para së gjithash për gjithë ata të burgosur që paraqesin rrezik të lartë për recidivizëm dhe ata me dënime afatgjatë.

## VII. LLOJET E REGJIMEVE

1. Shërbimi Korrektues i Kosovës me qëllim të risocializimit dhe rehabilitimit të të dënuarve, në kuadër të institucioneve korrektuese ose njërive të veçanta të një institucioni, për kategoritë specifike të të burgosurve menaxhon me një varg regjimesh si:

- Njësitë e mbyllura përmbajnë: Regjimin e Pranimit, Themelor, Standard, dhe i Avancuar. 
- Njësitë gjysmë të hapura përmbajnë: Regjimin Gjysmë të Hapur, dhe
- Njësitë e hapura përmbajnë: Regjim të Hapur.

2. Secili regjim ofron një varg privilegjesh dhe stimulimesh të ndryshme që rriten me avancimin e të burgosurit. Zakonisht të burgosurit në regjimin bazik do të marrin minimumin e garantuar me ligj të të drejtave që iu takojnë.

3. Ata të burgosur në regjimin standard dhe të avancuar do të marrin progresivisht më shumë privilegje, edhe pse saktësisht natyra e secilit privilegj do të varet sipas sigurisë së secilit burg.

4. Menaxhmenti i institucionit duhet të krijojë dhe të operojë me një skemë të shpërblimeve dhe sanksioneve. Shema duhet të jetë e përshtatshme duke ofruar stimulime reale dhe motivuese të cilat rrisin dhe shpërblejnë sjelljen e mirë e të aprovohet nga Drejtori i institucionit. Lista e sanksioneve të lejuara duhet të publikohet dhe nuk lejohen masa tjera jo zyrtare sanksionuese.

5. Sistemi i pushimeve jashtë burgut është pjesë integrale e regjimit të përgjithshëm të të burgosurve të dënuar.

6. Reduktimi apo privimi i kontakteve familjare nuk duhet të përdoret si sanksion.

7. Metodrat për inkurajim të bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes së të burgosurve në regjimet e tyre duhet të zhvillohen.

8. Mbjajtja e të burgosurit në cilin do nivel të regjimit por edhe ngritja apo ulja (degradimi) e tij varet nga sjellja dhe performanca e të burgosurit.

9. Me sjellje dhe performancë të mirë do të vlerësohet si:

- a. Higjiena personale, paraqitja dhe veshja e përshtatshme
- b. Respektim i rregullave të institucionit
- c. Përpjekjet dhe arritjet në punë dhe tjera aktivitete konstruktive si p.sh: pjesmarje e plotë në planifikim dënimi; aplikim dhe arritjet në edukim (duke përfshirë edhe trajnimet/kurset profesionale), qëndrim konstruktiv dhe dëshirë për të përfituar nga programet kryesore për trajtim, si p.sh: të kontaktojë me stafin e programeve, të kuptojë rëndësinë e programeve dhe t'i shfrytëzojë mundësitë që japin programet për nevojat e veta;

- d. T'i përkrahë përpjekjet e të burgosurve tjerë që them në planifikimin e tyre të dënimit; që të adresojnë sjelljen e tyre kalë e të bëjnë një jetë më konstruktive;
- e. Sjellje dhe gjuhë jo e dhunshme apo kërcënueseshfrytëzim apo frikësim;
- f. Pa diskriminim, respektimi i secilit pavarësisht, religjionin, rrethanasat personale. Pa racizëm, fyerje, gjeste të pahijshme;
- g. Sjellje njerëzore, duke mbajtur zërin në nivel të m e pa vrazhdësi;
- h. Respekt i ndërsjellët, p.sh: bashkëpunim me stafyerjes së detyrave të vetat, pajtohjet me pritjet a arsyeshme të stafit, pa teta gënjyer apo manipuluar stafin dhe të burgosurit tjerë;
- i. Trajtim korrekt ndaj të tjerëve, p.sh: dëshira për raportet të mira me të burgosurit tjerë dhe ofrimi i përkrahjes për ta, dhyrje në pronën e huaj;
- j. Qëndrimi larg nga gjërat e ndaluara p.sh. alkoolo çdo lloj kontrabande;
- k. Shprehja e mendimeve, kërkesave, ankesave kënaqësive në mënyrë të arsyeshme dhe konstruktive;
- l. Në respekt ndaj shëndetit dhe sigurisë së të t; pastërtia dhe rregulli i dhomave dhe hapësirave të tjera, përdorimi pajisjeve, materialeve dhe makinave të ndryshme, sillet në pajtim meat e sigurisë ndaj zjarrit, përfshirë edhe rregullat për pirje duhani;
- m. Shitblerja dhe shkëmbimi i gjëseneve mes të bështë e ndaluar.

10. Me rastin e transferit vullnetar të të burgosurve nga një inë tjetrin i burgosuri do të vendoset po në atë regjim që ka caktuar burgu dërgues por së ta kalojë nivelin e regjimit të pranimit.

11. Aplikimi nga ana e të burgosurit për privilegje dhe avancimes Aneksi A .

#### Ekipi Vlerësues i Bllokut

12. Vendimet rreth regjimeve adekuate duhet të arihen në drejtë dhe në pajtueshmëri dhe të bazohen në sjellje. Krahas sjelljes, performanca në arritja e objektivave të planifikimit të dënimit duhet po ashtu të merren në konsideratë e ekipit duhet të marrin parasysh nëse duhet të hetojnë nëse ndonjë prej stafit duhet një numër të tepëruar të vërejtjeve për ndonjë të burgosur apo të burgosurve në përgjithësi.

13. Udhëheqësi i bllokut kujdeset për mbledhjen dhe kompleporteve javore/mujore para çdo shqyrtimi. Ekipi vlerësues i bllokut është përgjegjës për en e të gjitha raportet të duhura për vlerësimin e situatës të të burgosurit dhe pjen në regjimin përkatës. Udhëheqësi i bllokut vendosë në bazë të propozimeve të ekipit.

14. Sa i përket vendosjes për regjim gjysmë të hapur dhe tevojitet edhe aprovimi nga drejtori i institucionit.

15. Ekipi vlerësues përbëhet nga: Udhëheqësi i bllokut, zyrtariceri korrektues, mbikëqyrësi i lartë, mjeku, psikologu / psikiatri në rast nevojari ligjor. Ekipi vlerësues i bllokut mbliidhet dhe është nën monitorimin e Udhëheqësit për dhe Regjime.

38. Të gjitha anekset që jepen për tu plotësuar duhet të jenë tura me numër të protokol lit. Këto anekse mbahen te Udhëheqësi për Programe dhe Regjiri

Aneksi 1

#### A. REGJIMI I PRANIMIT

1. Në këtë regjim do të vendosen të burgosurit :

- a. Që vijnë nga Gjykatat kompetente me vendim të shkruar;
- b. Me rastin e transferimit nga ndonjë institucion korrektues tjetër

u ② Çdo i burgosur i pranuar duhet të intervistohet brenda javës pas pranimit, nga stafi social, mjeku, sipas nevojës edhe psikologu, për t'i vlerësuar nevojat dhe nivelin e ndjeshmërisë së tyre dhe plotësohet dokumentacioni i nevojshëm.

X ③ Menaxhmenti duhet të sigurojë që stafi që e pranon të dënuarin në institucion, kujdes i veçantë duhet t'i kushtojë përcjelljes së informatës të stafi i ndërrimit të natës lidhur me anksozitetin, sjellje jo të zakonshme dhe të tërhequr të të dënuarit që mund të tregojë se ai mund ta lëndojë vetveten.

u ④ Mënyra e vendosjes të posa të pranuarit do të varet nga specifikat e cekura më lartë sipas paragrafit mbi vendosjen e të burgosurve dhe vetë kategorisë të të burgosurit në bazë të vlerësimit fillestar të sigurisë.

5. Ekipi vlerësues i bllokut nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të bllokut e bënë vlerësimin e të posa pranuarit brenda 3 deri në 28 dite për të dënuarit deri në tri vite burgim, , ndërsa për të dënuarit me dënim më të gjatë vlerësimi zgjat nga 7 ditë deri në 3 muaj. Ekipi takohet në baza javore, bënë shqyrtimin e raporteve javore (Aneksi B) dhe bënë vendosjen dhe klasifikimin e të burgosurit në regjimin adekuat (Aneksi D).

6. Në parim të burgosurit pas regjimit të pranimit kalojnë në regjim standard përpos kur sipas kushteve të caktuara dhe të cekura decidivisht kalohet në ndonjë regjim tjetër më të avancuar.

7. Për secilin të burgosur që ka dënim prej një (1) viti e tutje, menjëherë pas pranimit dhe pasi të studiohet personaliteti i tij nga ekipi multidisiplinor i institucionit, do të përgatitet planifikimi i dënimit.

8. Pas pranimit, dhe aq shpesh sa është e nevojshme të gjithë të burgosurit do të informohen me shkrim dhe me gojë, në gjuhën që e kuptojnë, për rregullat e institucionit dhe për të drejtat dhe detyrat e tyre në burg. I dënuari duhet të njohet edhe me procedurën e ankesave, rolin e stafit, organizatat jashtë institucionit.

9. Për dënimin dhe datat e lirimit duhet të bëhet kalkulimi dhe të informohen të dënuarit, në formë të shkruar dhe në mënyrë gojore, brenda tri ditëve të punës pas pranimit apo marrjes së vendimit.

10. Të dënuarve duhet lejuar që të mbajnë në posedim versionin me shkrim të informatave që iu jepet atyre.

11. Llogaritja e dënimit do të bëhet sipas lirimit normal të dënimit.

12. Personi i dënuar ka të drejtë telefonate pa vonesë për lajmërim të familjes se ku gjendet. Nëse ai nuk ka mundësi ta kryej telefonatën, z.social duhet ta kryejë atë për personin e dënuar.

13. Personat të cilët janë shtetas të huaj duhet t'u ofrohet mundësia për të kontaktuar përfaqësuesin e zyrës ndërlidhëse apo ambasadës me shkrim ose me telefon.

14. Nëse i burgosuri nuk respekton rregullat institucionit dhe në përgjithësi tregon sjellje të keqe pas periudhës 28 ditësh vendoset në regjim themelor.

15. Privilegjet në Regjimin e Pranimit :

- a. Vizita mujore - 2 orë në muaj
- b. Katër (4) telefonata në muaj (1 telefonatë në javë)
- c. Kantina në maksimum 25 € në javë
- d. Shëtitje dy (2)orë gjatë ditës
- e. Radio (nese i burgosuri e ka një të tillë)
- f. TV-një(1)orë gjatë mbrëmjes në TV-sallë (pa DVD/Video në dhomë/sallë) ose TV-dy(2)orë gjatë ditës dhe një(1)orë gjatë mbrëmjes në TV-sallë(pa DVD/Video në dhomë/sallë)
- g. Aktivitetet sportive dhe rekreative brenda bllokut
- h. Punësimi mund të bëhet vetëm në krahun e tyre
- i. E drejta ne shtyp ditor, tekste mësimore, libra.
- j. Lojërat mbështetëse janë të lejuara (shah, njeri mos u hidhëro, letra, domino).

**B. REGJIMI THEMELOR**

1. Ky regjim jep të drejtat minimale, sipas ligjit, standardeve dhe rregullave ndërkombëtare dhe është për ata të burgosur:

- a. Të cilët ulen nga regjimi standard për shkak të sjelljes së tyre të dështuar;
- b. Nga regjimi i pranimit pasi kanë treguar sjellje jo të mirë;
- c. Për të burgosurit që vijnë nga regjimi i ndarjes jovullnetare;
- d. Të burgosurit të cilët vijnë pas mbajtjes së vetmisë;
- e. Për të burgosurit të cilët përmes sjelljes dhe qëndrimit të tyre refuzojnë për tu përshtatur rregullave të burgut në përgjithësi;
- f. Dështojnë të demonstrojnë një marrëdhënie të kënaqshme me stafin, profesionistët tjerë dhe të burgosurit tjerë;
- g. Nuk dëshirojnë të punojnë;
- h. Nuk adresojnë sjelljen e tyre kundërligjore;
- i. Kanë vazhdimisht sjellje jo të mira;
- j. Kanë një dosje të papranueshme disiplinore.

2. Të burgosurit që vendosen në këtë regjim duhet të vlerësohen brenda shtatë (7) dite (Aneksi B) dhe të informohen për hapat konkret çka pritet prej tyre për t'u kthyer në regjim standard. Kjo duhet të përfshijë objektivat konkretë që do t'u ndihmojë atyre që të përparojnë nga regjimi themelor. Këta të burgosur përcillen përmes regjistrit ditor (Aneksi E).

3. Të burgosurit që mbeten në këtë regjim duhet të vlerësohen së paku një herë në muaj nga ekipi vlerësues i bllokut.

4. Vetëm Drejtori i institucionit apo Zëvendës Drejtori mund të autorizoj vendosjen e të burgosurit në regjim themelor si rezultat i një incidenti.

Vazhdimi i Regjimit Themelor



1. Nëse edhe pas periudhës së 28 ditëve i burgosuri vazhdon sjelljen e tij destruktive (të rregulluar) ose nuk pajtohet me rregullat përkatëse, regjimi i tij do të vazhdohet edhe për 28 ditë të tjera (Aneksi D). Pas përfundimit të kësaj periudhe ekipi multidisiplinar mund të bëjë një plan veprues për të. I burgosuri do ta vazhdojë regjimin themelor në vazhdimësi por do t'i lejohet edhe të marr pjesë në aktivitete me të tjerët. Por duhet t'i ketë qartë kufijtë e vet dhe të mësoje se si pritjet nga ai një sjellje më e mirë. Gjatë periudhës së ardhshme ky rast mund të rishikohet edhe për një transferim të mundshëm për një kohë të caktuar në një burg tjetër/ qendër paraburgimi.

2. Të drejtat e regjimit themelor janë të njëjta me ato të regjimit të pranimit.

### C. REGJIMI STANDARD

1. Në këtë regjim do të vendosen ata të burgosur që vijnë nga regjimi i pranimit apo themelor.

2. Për të kaluar nga regjimi i pranimit/themelor në regjimin standard personi i dënuar duhet të ketë së paku katër raportet e fundit javore me rekomandim për avancim si dhe të jetë së paku 28 ditët e fundit pa masa të shqiptuara disiplinore. Ekipi vlerësues i bllokut pas shqyrtimit final do të bëjë klasifikimin e tij për në regjimin standard (Aneksi D).

3. Regjimi standard përfshin të gjithë ata të burgosur që:

- a. mbajnë qetësin, pastërtinë dhe higjienën personale në nivelin e pranueshëm;
- b. marrin pjesë aktivisht në rutinën e përbashkët;
- c. respektojnë rregullat dhe rendin shtëpiak;
- d. demonstrojnë dhe shfaqin marrëdhënie të mira dhe të shëndosha me stafin dhe të burgosurit e tjerë;
- e. pjesëmarrja në punë (nëse është e mundur);
- f. marrin pjesë në planifikim dënimi
- g. qëndrojnë larg nga gjërat e ndaluara p.sh. alkooli, droga apo çdo lloj kontrabande;
- h. shprehin mendime, kërkesa, ankesa apo pakënaqësi në mënyrë të arsyeshme dhe konstruktive;

4. Vlerësimi i të burgosurve në regjimin standard bëhet për çdo muaj nga ekipi multidisiplinar duke përdorur Aneksin C.

5. Të burgosurit në regjimin standard mund të aplikojnë që të ngrihen në regjimin e avancuar pas tre (3) muajve, dhe pas kësaj në çdo periudhë tre mujore.

6. Të burgosurit që nuk aplikojnë për avancim dhe gjithë ata që ngrihen në regjimin avancuar duhet të vlerësohen për çdo vit për t'u siguruar se sjellja e tyre reflekton nivelin e shfrytëzimit të privilegjeve. Një vlerësim i mëhershëm mund të marrë pjesë nëse ka ndryshime në sjelljen e gjithmbarshme apo të performancës.

7. Privilegjet në Regjimin Standard do të jenë:

- a. Vizita mujore - 2 orë në muaj, plus 1 ekstra vizite një orësh, brenda tre muajve, me aprovim të Drejtorit të Institucionit
- b. Katër (4) telefonata në muaj ( 1 telefonat në javë)

- c. Kantina 25 (30) € në javë
- d. Shëtitje (dy) 2 ore në ditë
- e. TV në dhomë, Radio, pajisje shtesë për dëgjimin e muzikës
- f. Aktivitete sportive në sallë dhe fusha sportive
- g. Punësim brenda dhe jashtë ndërtesës së banimit
- h. E drejta në shtyp ditor, tekste mësimore, libra.
- i. E drejta në edukim dhe trajnime profesionale
- j. Lojna mbështetëse (shah, njeri mos u hidhëro, letra, domino)
- k. Vizitat e lira në lokale të veçanta 1 herë në 3 muaj

#### D. REGJIMI I AVANSUAR

1. Për ata të burgosur sjellja e të cilëve është vazhdimisht në standard të lartë dhe të cilët bashkëpunojnë plotësisht me stafin dhe me anëtarët e tjerë profesional gjatë menaxhimit të mbajtjes së tyre.

2. Kriteret që kërkohen për të kaluar në këtë regjim janë:

- a. Të ketë formën e prer / të plotfuqishëm të aktgjykimit për dënim.
- b. Të demonstrojnë marrëdhënie të mira me stafin dhe të burgosurit e tjerë
- c. Tri raporte rekomanduese të njëpasnjëshme mujore të stafit të pavijonit
- d. Punojnë
- e. Marrin pjesë në planifikim dënimi
- f. Të mos i jete shqiptuar ndonjë dënim disiplinor brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit
- g. Të mos jetë vendosur në regjimin themelor të vetmisë brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit
- h. Të jetë i punësuar vazhdimisht ose është aktiv dhe organizon punën
- i. Të mos kenë qenë i pushuar nga puna brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit
- j. Në asnjë mënyrë nuk duhet të jetë i përfshirë në ndonjë protestë apo refuzim të urdhrave të stafit.

69. Personat e dënuar, të cilët plotësojnë kriteret e mëposhtme, do të kalojnë nëpër procedurë të shkurtër (7 ditë regjim pranimit dhe 28 ditë regjim standard) që të kalojnë në regjim të avancuar nëse :

- a. vijnë vullnetar në vuarje të dënimit.
- b. dënim i tyre nuk kalon 3 vite
- c. nuk është recidivist
- d. niveli i rrezikshmërisë është i ulët

70. Për të dënuarit të cilët kanë dënimin e shkallës së parë dhe kanë vonesa në vendimin final avancimi i tyre mund të bëhet nëse personi i dënuar ka kaluar 1/3 e dënimit të shqiptuar.

71. Për personat e dënuar që me lejen (urdhëresën) e gjykatës ekzekutohet urdhri i burgimit në gjysmë liri (LESP – neni 164,165)

72. Gjithashtu i burgosuri mund të vendoset në regjimin e avancuar me rastin e ardhjes nga ndonjë burg tjetër që ka qenë në regjimin e avancuar.

73. Pata se të bëhet shqyrtimi kryesor për regjimin e avancuar raportet kompletojnë në mënyjë ekipi profesional të jetë i gatshëm për të bërë klasifikimin e duhur.

**74. Privilegjet në Regjimin e Avansuar:**

- a. Vizita mujore- 2 orë në muaj plus 1 ekstra vizitë një orëshe, brenda një muaji aprovim të Zv. Drejtorit të Institucionit
- b. Të të (8) telefonata në muaj
- c. Kantina 40 € në javë
- d. Shëtitje 2 (dy) ore ne dite
- e. TV në dhomë me DVD/Video, pajisje shtese për dëgjimin e muzikës
- f. Aktivitetet sportive në sallë dhe fusha sportive
- g. Mundësi që të punojë jashtë perimetrit të banimit nën mbikëqyrje
- h. E drejta ne shtyp ditor, tekste mësimore, libra.
- i. E drejta në edukim dhe trajnime profesionale
- j. Lojra mbështetëse (shah, njeri mos u hidhëro, letra, domino)
- k. Mundësi në vizitat e lira në lokale të veçanta dy herë në tre muaj (për ata që shfrytëzojnë pushimin jashtë burgut) .
- l. Mundësi për pushim jashtë burgut dhe pushim te jashtëzakonshëm

**E. REGJIMI GJYSMË I HAPUR**

75. Të dënuarit të cilët janë të pranueshëm për t'u vendosur në Regjimin Gjysmë Hapur janë dënuarit e Regjimit të Avancuar.

76. Brenda institucionit, të burgosurit mund të vendosen në njësi gjysmë të hapur, brenda një muaji të mbyllur në të cilin aplikohet regjimi gjysmë i hapur.

77. Kriteret për kalim në regjimin gjysmë të hapur janë:

- a. Të ketë dënimin e plotfuqishëm,
- b. Të mos ketë vepra tjera penale në pritje,
- c. Të mos ketë ndëshkime disiplinore gjatë periudhës së kaluar gjatë (6) muajve
- d. Të jetë në gjendje të mirë mentale dhe fizike
- e. Të jetë çdo herë i gatshëm për punë
- f. Të merr pjesë në planifikim dënimi
- g. Pjesa e mbetur e dënimit të tyre të mos kaloj 3 (tri) vite

78. Të dënuarit të cilët vijnë vullnetar në vuajtje të dënimit, dënimi i tyre nuk kalon 1 vit, dhe kalojnë në procedurë të shpejtuar pasi që të jetë bërë vlerësimi i tyre pas 7 dite nga data e pritjes.

79. Personat e dënuar me dy aktgjykimë të plotfuqishme me dënim të unifikuar mund të aplikojnë për regjimin gjysmë të hapur nëse dënimi i dytë nuk kalon mbi një vit.

80. Po ashtu, të dënuarit të cilët kanë shfrytëzuar Peshirnin jashtë burodit të kaluar një (1) vjeçare duke i respektuar të gjitha procedurat dhe që pjesa e mbetur të mos kalojë pesë (5) vite, në bazë të vlerësimit dhe rekomandimit të Ekspertit Multidisiplinor dhe vendimit të Drejtorit mund të vendosen në Regjimin Gj. të Hapur.

81. Për vendosje në regjimin gjysmë të hapur nevojitet edhe aprovim i Komitetit të Institucionit.

82. Vlerësimi për Regjimin Gj. të Hapur bëhet nga ekipi multidisiplinor i Aneksit G.

83. Privilegjet në Regjimin Gjysmë të Hapur :

- a. Vizita mujore – 4 orë në muaj (një vizite në javë);
- b. Telefonatat e pakufizuara (sipas orarit të caktuar);
- c. Kantina 50 € në javë;
- d. Shëtitje 2 (dy) ore në ditë;
- e. TV në dhomë me DVD/Video, Radio, pajisje shtesë për muzikës;
- f. Aktivitetet sportive në sallë dhe fusha sportive sipas të caktuar në rrethim shtëpiak;
- g. Mundësi që të punojë jashtë perimetrit të burgut pa mbikëqerje;
- h. E drejta në shtyp ditor, tekste mësimore, libra;
- i. E drejta në edukim dhe trajnime profesionale;
- j. Lojna mbështetëse (shah, njeri mos u hidhëro, letra, domo etj.);
- k. Mundësi për pushim jashtë burgut dhe pushim të jashtëzakonshëm në ditë të jashtëzakonshme;
- l. Mundësi për ditë shtese të pushimit në shtëpi në rast të nevojës të jashtëzakonshme në punë;
- m. Mundësi të marrjes së pakove ushqimore, një (1) herë në muajt të parësorë nga pushimi i rregullt në shtëpi (sipas rregullores së brendshme të institucionit dhe ligjit).

## F. REGJIMI I HAPUR

84. Te burgosurit, që punojnë apo marrin pjesë në aktivitete tjera reja të cilët janë të vlerësuar se janë të adaptueshëm kushteve pa kufizim të burgjeve të cilët supozohen se nuk do ta lëshojnë institucionin pa leje vendosen në njësi të hapur.

85. Brenda institucionit, të burgosurit mund të vendosen në njësi të hapura të burgut të mbyllur, gjegjësisht në njësi të veçanta në të cilat aplikohet regjimi i hapur.

86. Në këto njësi vendosen të burgosurit që kanë dënim ose që mbetur të vuajtur është deri në 1 vit.

87. Në këtë regjim vendosen edhe ata të burgosur:

- a. Sjellja e të cilëve është në nivelin më të lartë;
- b. Marrin pjesë aktivisht në programet e parapara për ta;
- c. Përfillin plotësisht rregullat e institucionit;
- d. Ata të burgosur që kanë një dosje të pastër pa asnjë shkelje të rregullave të burgut.

88. Para se të dërgohet i dënuari në njësi të hapur i bëhet një vlerësim i shmërisë që të testohet se a është i përshtatshëm për atë regjim. Interes i veçantë i brendshëm i shmërisë së të

burgosurit ndaj komitetit dhe është në gjendje që të ikë. Vendimi përfundimtar i kësaj Drejtorit të Institucionit por me njohënin paraprak të Drejtorisë Qendrore të SHKK-së.

89. Regjimi i hapur bazohet plotësisht në besim. Por çfarëdo llyerje e atij besimi do të dënohet me shqiptim të një regjimi më të rreptë.

90. Privilegjet në Regjimin e Hapur:

- a. Vizita të pambikëqyrura- 8 orë në muaj
- b. Telefonatat e pakufizuara sipas orarit të përcaktuar
- c. Kantina 70 € në javë
- d. Shëtitje 2 (dy) ore në ditë
- e. TV në dhomë me DVD/Video, pajisje shtese për dëgjimin e muzikës
- f. Aktivitetet sportive në sallë dhe fusha sportive.
- g. Mundësi që të punojë jashtë perimetrit të burgut pa mbikëqyrje
- h. E drejta në shtyp ditor, tekste mësimore, libra.
- i. E drejta në edukim dhe trajnime profesionale
- j. Lojra mbështetëse (shah, njeri mos u hidhëro, letra, domino)
- k. Mundësi për pushim jashtë burgut dhe pushim të jashtëzakonshëm
- l. Mundësi për ditë shtesë të pushimit në shtëpi në rast të kontributit të jashtëzakonshëm në punë
- m. Mundësi të marrjes së pakove ushqimore pas kthimit nga pushimi i rregullt në shtëpi, (sipas rregullores së brendshme të institucionit)
- n. Mund të përgatisin vetë ushqimin
- o. Mund t'i veshin rrobat e veta personale

91. Të burgosurit mund të shëtisin lirshëm jashtë perimetrit gjatë kohës së lirë, por së pari duhet të lajmërojnë daljen dhe të marrin leje lëshimin nga institucioni.

## VIII. RREGJIMET SPECIFIKE

A. Regjimi për të Burgosurit me Rrezikshmëri të Lartë e kategorizuar sipas Rregullorës nga KKB-ja

92. Për këto kategori të të burgosurve duhet aplikuar, aq sa është e mundur, rregulla të zakonshme të burgut por me masa të shtuara të sigurisë;

93. Të aplikohen masa të sigurimit vetëm në atë masë sa pajtë të kërkohen;

94. Të aplikohen masat e sigurisë në atë mënyrë që respekton të drejtat dhe dinjitetin njerëzor.

95. Të burgosurit me rrezikshmëri të lartë duhet të vendosen të vetëm në një dhomë përpos nëse Drejtori i institucionit jep tjetër autorizim me shkrim sipas aktit nënligjor që Rregullon Kategorizimin e të Burgosurve.

96. Të burgosurit me rrezikshmëri të lartë kategori kanë të drejtë në edukim, trajnime profesionale, punë, dhe aktivitete rekreative aq sa lejojnë kushtet e sigurisë brenda njësisë së veçantë;

97. Këta të burgosur kanë të drejtë për gjësim të njëjta personale si të burgosurit që nuk i takojnë kësaj kategorie përpos nëse janë duke vizituar ndonjë dënim disiplinor.

98. Komunikimi përmes telefonatave monitorohet.

99. Të gjithë të burgosurve duhet t'u bëhet vlerësimi i sigurisë brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit. Nëse gjatë këtij vlerësimi hasen elemente se i burgosuri mund t'i takoj rrezikshmërisë së lartë, Drejtori i Institucionit duhet të përcjell rastin tek Komisioni për Kategorizimin e të Burgosurve në DQ të SHKK-së. Rivlerësimi duhet të bëhet çdo 28 ditë në institucion dhe çdo 6 muaj në DQ të SHKK-se. Sistemi i shqytimeve të rregullta kohore siguron që koha e kaluar në kushte të përforcuara siguruese të burgut dhe niveli i sigurisë që aplikohet të mos kalojë aq sa kërkohet;

100. Privilegjet t'u takojnë sipas kategorisë dhe regjimit themelor që i përket sipas aktit nënligjor qw Rregullon Menaxhimin e të Burgosurve me kategori.

101. Sipas vendimit të Drejtorit, këtyre të burgosurve mund t'iu hiqen kufizimet gjatë vizitave.

### **B. Regjimi i ndarjes së të burgosurit (LESP, Neni 34)**

102. Me kërkesë të personit të dënuar, drejtori i institucionit korrektues mund të lejojë që personi i dënuar të ndahet nga personat tjerë të dënuar në një njësi të veçantë të institucionit korrektues dhe nëse drejtori konstaton se shqetësimet e paraqitura në kërkesën e personit të dënuar janë të arsyeshme dhe nuk ka mundësi të tjera për zgjidhjen e tyre.

103. Drejtori i institucionit korrektues mund të urdhërojë që personi i dënuar të ndahet nga personat e tjerë të dënuar edhe pa kërkesën e personit të dënuar vetëm kur kjo masë është e nevojshme:

- a. Për t'iu shmangur rrezikut për jetën ose shëndetin e personit të dënuar ose të personave tjerë;
- b. Për t'iu shmangur rrezikut të sigurisë në institucion korrektues të shkaktuar nga prania e vazhdueshme e personit të dënuar në mesin e të burgosurve e personave të tjerë të burgut;
- c. Për të siguruar integritetin e hetimit të ndonjë çështjeje disiplinore.

104. Ndarja nuk mund të lejohet për një periudhë që i kalon 30 ditë. Vendimi i tillë rishikohet për aq sa ka nevojë, por të paktën një herë në 10 ditë.

105. Kur ndarja është urdhëruar për parandalimin e personit të dënuar për të mos ndikuar në personin tjetër të dënuar në shkeljen e rëndë të rendit brenda institucionit korrektues ose për parandalimin e tij në kryerjen e aktivitetit të vazhdueshëm kriminal në institucionin korrektues, personi i dënuar mund të vendoset në njësi të veçantë të institucionit korrektues kur pritet që ndarja të zgjasë shumë.

106. Drejtori i institucionit mund të urdhërojë ndarjen e personit të dënuar i cili sillet në mënyrë të dhunshme nga personat tjerë të dënuar pa kërkesën e tij për aq sa është e nevojshme të pengoj sjelljen e tij të dhunshme.

107. Formulari i përcjelljes ditore të të burgosurit (Aneksi E) bëhet për secilin të burgosur i cili është ndarë me kërkesën apo pa kërkesën e tij.

108. Personeli i kualifikuar shëndetësor e kontrollon personin e dënuar të ndarë se paku një herë në ditë dhe sipas nevojës.

109. Vendimi për ndarjen e personit të dënuar nga personat tjerë të dënuar ndërpritet posa të pushojë së ekzistuari arsyet për urdhrin e ndarjes, ose në raste kur personeli i kualifikuar shëndetësor konstaton se vazhdimi i ndarjes do të jetë i dëmshëm për shëndetin e personit të dënuar.

#### Privilegjet

110. Personit të dënuar të ndarë prej personave tjerë të dënuar i njihen të njëjtat të drejta, benificione dhe kushte sikurse ato të cilat i gëzojnë të gjithë të burgosurit tjerë përveç atyre benificioneve të cilat mund të gëzohen vetëm bashkërisht me të burgosurit tjerë apo të cilat nuk mund të sigurohen për shkak të kufizimeve që i kanë njësitë e institucionit korrektues në të cilin është i vendosur personi i dënuar i ndarë.

111. Të gjithë të burgosurit e ndarë vazhdojnë të kenë të drejtë të vizitohen nga mbrojtësi i aprovuar i tyre, kryetari i Gjykatës Kompetente (ose i deleguari i tij), Ombudspersoni dhe të gjitha organizatat tjera monitoruese të lejuara.

112. Të burgosurve të ndarë privilegjet iu takojnë sipas regjimit nga i cili kanë ardhur dhe pas përfundimit të ndarjes kthehen në regjimin në të cilin ishin para ndarjes, përveç nëse kanë treguar sjellje negative gjatë regjimit të ndarjes. Në këtë rast të dënuarit kthehen në një regjim më të ulët. Përndryshe ata mund të marrin pjesë në aktivitete nëse vlerësohet se nuk paraqesin rrezik për personat e dënuar të tjerë dhe sigurinë e përgjithshme të aktiviteteve tjera të Institucionit.

113. Menaxhmenti i institucionit duhet të sigurojë që të dënuarve të ndarë, t'i jepet mundësia që të angazhohen në edukim, trajnime profesionale dhe në punë.

114. Vizitat e të burgosurve të ndarë me kërkesë duhet të jenë të hapura sipas regjimit të cilit i kanë takuar më parë.

115. Personat e ndarë kanë të drejtë të mbajnë një kopje të vendimit për ndarje, Aneksi F.

#### C. Regjimi i Vetmisë

116. Dënimi disiplinor i vetmisë konsiston në mbajtjen e vazhdueshme në izolim të personit të dënuar në dhomë të veçantë.

117. Dhoma për ekzekutimin e vetmisë ka një hapësirë prej së paku dhjetë (10) metra kub, pajisje sanitare, dritë natyrale, ujë të pijshëm, shtat me qarshafë, tavolinë, karrige dhe ngrohje.

118. Vetmia (bazuar në LESP nenin 110) shqiptohet vetëm për shkelje të rënda disiplinore, dhe nuk mund të zgjatë më tepër se 15 ditë.

119. Në rastin e shqiptimit të dënimit disiplinor të vetëm për shkelje disiplinore në bashkim, vetmia nuk është më e gjatë se 30 ditë.

120. Periudha e përgjithshme e vetmisë nuk mund të jetë më e gjatë se 2 muaj gjatë një viti kalendarik.

121. I dënuari kontrollohet nga mjeku para se t'i ekzekutohet dënimi disiplinor i vetmisë. Mjeku përmes raportit me shkrim konstaton se i dënuari është në gjendje të aftë psiko fizike për mbajtjen e vetmisë.

122. Gjatë ekzekutimit të vetmisë personi i dënuar i gëzon të njëjtat kushte higjienike dhe shëndetësore si të burgosurit tjerë.

123. Ushqimi do t'iu servohet në dhomë.

124. I lejohet qëndrimi jashtë ambientit të mbyllur së paku dy (2) (1) orë në ditë për ajër të pastër dhe për ushtrime ( në shëtitore të veçantë).

125. Ka të drejtë në vizitë familjare një herë nga një (1) orë (30 min.), gjatë 15 ditëve.

126. Ka të drejtë në shtyp ditor, tekste mësimore, libra.

127. Se çfarë gjësendesh tjera do t'iu lejohet personave në vetmi varet nga vendimi i Drejtorit të institucionit i cili bazohet në bazë të rrezikshmërisë së tyre qoftë ndaj vetes, pronës së institucionit ose ndaj të tjerëve.

128. Sjellja e tyre vëzhgohet çdo ditë dhe plotësohet formulari i përcjelljes ditore (Aneksi E).

129. Personi në vetmi vizitohet nga mjeku çdo ditë, drejtori dhe zyrtari social e vizitojnë një herë në 7 ditë ose kur e kërkon nevoja edhe më shpesh.

130. Pas kryerjes së vetmisë i burgosuri do të kthohet në regjim themelor.

#### D. Regjimi për femrat shtatzënë dhe ato me fëmijë

131. Gratë shtatzëna, gratë që lindin fëmijë dhe nënat që përkujdesen për fëmijët e tyre vendosen ndarazi nga gratë tjera të dënuara.

132. Femrat shtatzënë dhe ato me fëmijë pranohen në regjim pranimit por me privilegje të regjimit standard. Regjimi i burgut duhet të jetë fleksibil mjaftueshëm që t'iu përgjigjet nevojave të tyre. Kujdes i veçantë duhet të ekzistojë në institucione me qëllim që t'iu mundësojë atyre pjesëmarrje në aktivitetet e burgut dhe programe adekuate.

133. Femrat e dënuara të afta për punë kanë të drejtë pune si brenda ashtu edhe jashtë institucionit korrektues.

134. Femrat shtatzënë kanë të drejtë të mos punojnë për shkak të shtatzënisë, lindjes dhe amësisë, në pajtim me dispozitat e përgjithshme të punës në institucion korrektues.

135. Femrave duhet ofruar programe të duhura dhe shërbime që t'iu plotësojë nevojat e tyre fizike, sociale dhe psikologjike.

136. Grupet e veçanta të femrave, femrat e mitura, femrat me aftësi të kufizuara, femrat me nacionalitet të huaj dhe të tjera minoritetëve, kanë edhe më tepër nevoja të veçanta si femra.



137. Kur fëmija të mbahet në institucione korrektuese me nënën e tij, do të merren masa të posaçme për sigurimin e një dhome fëmijësh.

138. Dhoma për vizita me fëmijë duhet të jetë me një ambient shumë të përshtatshëm për fëmijë (pa prezencën e oficerëve korrektues), i shndritshëm me ngjyra me hapësirë të mjaftueshme për lojra të fëmijëve dhe ulëse komode. Të gjitha vizitat në pavijonet e femrave janë "vizita kontakti", që do të thotë aty nuk ka kufizime sa i përket përqaftimeve, ulje në prehër, mbajtje në kraharor etj. Vizitat që përfshijnë kontakt me te zgjatur me fëmijët duhet inkurajuar, sa here që ka mundësi.

139. Vizitat nga familjarët lejohen së paku 8 herë në muaj.

140. Për vizitat që u bëhen nënave të dënuara nga fëmijët e tyre do të zbatohen rregulla të veçanta institucionale që atyre tu mundësojnë vizita me te rregullta.

141. Femrat e dënuara kanë të drejtë vizite në lokale të veçanta sikur edhe të dënuarit meshkuj.

142. Gratë shtatzëna kërkojnë një vëmendje të veçantë sa i përket dietës, veshjeve, barnave, dhe përkujdesjes shëndetësore. Ato kanë nevojë për larje më të shpeshta dhe tush.

143. Dënimi me vetmi apo ndarje pa kërkesën e vet nuk duhet të aplikohet ndaj femrave shtatzëna dhe atyre me fëmijë.

144. Dënimet disiplinore për femrat e burgosura në përgjithësi nuk duhet të përfshijnë ndalimin e kontakteve familjare, veçanërisht me fëmijët.

#### Foshnjat në burg

145. Foshnjat që jetojnë në burgje me nënat e tyre nuk duhet trajtuar si të burgosur. Moshë e fëmijëve që mund të rijnë në burgje është deri në 18 muaj.

146. Akomodim i veçantë duhet të bëhet për ta për të mbrojtur mirëqenien e tyre.

147. Ato kërkojnë një kujdes të specializuar shëndetësor. Kujdesja e tyre duhet të bëhet nga staf i kualifikuar në kohën kur nënat janë të angazhuara në aktivitete aty ku foshnjat nuk mund të jenë prezente.

#### E. Regjimi për Dëshmitarët e Mbrojtur

148. Për Dëshmitarët e mbrojtur përcaktohen regjimet sipas dokumentit për Dëshmitarët e mbrojtur.

#### F. Regjimi për të Paraburgosurit

149. Regjimi për të paraburgosurit zbatohet sipas Rregullores mbi të Paraburgosurit dhe aktin nënligjor /Rregullave Shtëpiake

#### G. Regjimi për të Miturit

150. Regjimet për të miturit zbatohen sipas Rregullores mbi të Miturit dhe Rregullave Shtëpiake.

### **IX. MËNYRA E IMPLEMENTIMIT TË REGJIMIT**

### Ullja e Regjimit

151. Dënimi disiplinor është në proporcion me shkelljen disiplinore të kryerit i dënuar. Personi i dënuar nuk mund të dënohet dy herë për të njëjtën veprë (LESP, N). Për të burgosurit nuk mund t'i shqiptohen dy masa disiplinore për të njëjtën veprë.

Ullja e regjimit nuk konsiderohet dënim disiplinor.

152. Nëse sjellja e të burgosurit apo mungesa e progresit tregon se ai nuk është në nivelin e vet momental të regjimit, ai mund të degradohet në një nivel më poshtë (si disipline, jo si dënim i shqiptuar me vendim). Një degradim i madh i të burgosurit si përcaktuar në themelor duhet shmanjur përpos në rastet më të rënda të keqsjelljes së tij. Në këto raste vendimet i merr drejtori i institucionit.

153. Sistemi disiplinor dhe ai i regjimeve-përfundimit të privilegjeve janë të ndara. Nivelet e regjimeve determinohen në bazë të sjelljes. Procesi disiplinor i mbajtjen e rendit dhe disiplinës përbrenda burgut duke shpërblyer dënimet për incidente. Mund të ketë raste kur sjellja rezulton si me seanca disiplinore për veprim specifik ashtu në shqyrtimin e nivelit të regjimeve sepse sjellja e të burgosurit bie poshtë standardeve.

154. Humbja e privilegjit të caktuar si pasojë e dënimit disiplinor, apo që kompetencë të drejtorit të institucionit nuk duhet të rezultojë automatikisht në humbjen e privilegjit.

155. Çdo herë kur i dënuari nuk i respekton rregullat e institucionit dhe në të cilin gjendet, oficeri korrektues, i cili përcjell të dënuarin, ka për obligim të përkëqyrësin e lartë. Mbikëqyrësi i lartë ka për obligim të bisedojë me të dënuarin me qëllim të rritjes dhe ta njoftojë se do të jetë nën përcjellje për dhjetë (10) ditë e ardhshme për të sjelljen dhe performancën. Për sjelljen e të dënuarit në baza ditore njoftohet edhe Udhëheqësi.

156. Degradimi nga regjimi standard në regjimin themelor parashihet disa hapa ndërmarrë:

- a. Nëse i burgosuri dështon në pëmbushjen e kritereve të përcaktuarin standard
- b. Tri vërejtje me shkrim brenda periudhës tre mujore
- c. Shpallet fajtor për shkelje disiplinore
- d. Refuzon të punoj apo të marr pjesë aktive në planin e planifikimit

157. Degradimi nga regjimi i avancuar në atë standard:

Personi i dënuar do të ulët në regjim standard nëse:

- a. Dënohet me masë velmie sipas raportit disiplinor
- b. Merr dy vërejtje me shkrim të disfavorshme në tre muajt e fundit
- c. Gjendet fajtor në ndonjë shkelje disiplinore
- d. Dështimi i pëmbushjes së kritereve të regjimit të avancuar
- e. Refuzon të punoj apo të marr pjesë aktive në planin e planifikimit

158. Me këtë rast bëhet propozimi për uljen e regjimit (Aneksi D). E disiplinor bëhet propozimin për degradim, kurse e aprovon Zv. Drejtori.

159. Të burgosurit informohet për përmbajtjen e çdo raporti, posaçërisht disiplinore duke ju dhënë atyre mundësinë për ta përmirësuar sjelljen e tyre dhe nësevojshme të japin koment në çfarëdo raporti.

160. Procedura e uljes nga regjimi gjysmë i batur në regjim stambullorë (regjimi me bërë regjimit të avancuar.

## X. AKTIVITETET E REGJIMEVE

161. Aktivitetet e regjimeve mund të përfshijnë:

- a. shkollimin;
- b. trajnimet profesionale;
- c. punën dhe terapitë okupuese;
- d. shkathtësitë sociale dhe trajnimet kompetente;
- e. menaxhimi i agresivitetit;
- f. terapinë për varësi;
- g. terapinë individuale dhe grupe;
- h. edukimi fizik dhe sporti;
- i. edukimi terciar dhe vazhdues;
- j. programet për drejtësi restorative dhe bërja e riparimeve përkak të veprës;
- k. aktivitetet e lira kreative dhe hobi;
- l. aktivitetet jashtë institucionit në komunitet, pushimet ditore format tjera të pushimit; dhe
- m. përgatitja për lirim dhe i përkujdesjes së pas lirim.

162. Regjimet dhe programet janë të ndërlidhura dhe mbështesja tjetrën.

163. Këto aktivitete duhet të përfshijnë nevojat individuale të të burgosurve në pajtim me moshën e tyre, gjininë, prejardhjen sociale dhe kulturore, shëndet dhe zhvillimin dhe veprën e kryer.

164. Të burgosurit do të vendosen vetëm në ato programe të cilat përshtaten pas konsultimeve të duhura me Zyrtarin social i cili pastaj rekomandon për kërkim të ekipi multidisiplinar i planifikimit të dënimit. Ekipi multidisiplinar në bazë të raportit zyrtar social vendosë për rrjedhën e mëtejshme të zhvillimit të procedurës.

165. Institucioni duhet poashtu të japë aktivitete kuptimplote edhe vikendeve dhe pushimeve.

166. Qëllimi i të gjitha programeve duhet të jetë riintegrimi i shtetëri i personave të dënuar në shoqëri. Për të ndihmuar në këtë, pjesëmarrja e institucion publike dhe private duhet të inkurajohet. Grupet do të inkurajohen të ndihmojnë të bërë në rehabilitimin e tyre posaçërisht lidhur me familjen dhe punësimin.

167. Programet janë më të suksesshme kur ka të bëjë me nivelin e bashkëpunimit në mes stafit dhe të burgosurve. Lidhur me këtë duhet të inkurajohet një dinamikë.

### A. Arsimi

168. Çdo burg duhet t'iu japë të gjithë të burgosurve të drejtën për marrë pjesë në programe edukative të cilat janë të kuptueshme dhe plotësojnë nevojat individuale duke marrë parasysh aspiratat e tyre.

169. Edukimi në institucion kontaktues ka për qëllim të zhvillojë personin duke marrë parasysh kontekstin e tij/saj social, ekonomik dhe kulturor.

170. Pëi parësi u jepet të burgosurve që kanë probleme me shkollim e numërim dhe atyre që nuk kanë arsimin bazë ose profesional.

171. Vëmendje e veçantë i kushtohet arsimimit të të burgosurve në moshë të re dhe atyre me nevoja të veçanta.

172. Personi i dënuar ka të drejtë në shkollim fillor dhe të mesëm në pajtim me ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm, përderisa për personat e dënuar analfabet organizohen kurse të posaçme. Përmes programeve të veçanta Drejtori i Institucionit korrektues i mundëson personit të dënuar vijimin e shkollimit universitar apo ndonjë shkollim tjetër. Shpenzimet e shkollimit të tillë i mbulon personi i dënuar.

173. Trajnimet profesionale duhet të kenë për qëllim një zhvillim më të gjorë të individit, e po ashtu të jenë të vëmendshme për drejtimit që ekzistojnë në tregun e punës.

174. Edukimi s' duhet të ketë status më të ulët se puna përbrenda regjimit të burgut dhe të burgosurit nuk duhet të jenë në situatë të pafavorshme financiarisht apo në mënyrë tjetër nëse marrin pjesë në edukim.

175. Programet edukative për të burgosurit e dënuar përgatiten në varësi të zgjatjes së parashikuar të qëndrimit në burg.

176. Çdo institucion duhet të ketë bibliotekën, e cila përdoret nga të gjithë të burgosurit, e pajisur siç duhet me një gamë të gjerë mjetesh edukative e çlodhëse, libra e mjete tjera të komunikimit.

### B, Puna

177. Puna në burg duhet të konsiderohet si element pozitiv i regjimit të burgut dhe kurrë nuk duhet të përdoret si formë e dënimit disiplinor.

178. Institucioni duhet të japë punë të mjaftueshme për të dënuarit i cili është stimulatív dhe me vlerë edukuese.

179. Puna duhet proporcionalisht të shpërblehet.

180. Kur të dënuarit marrin pjesë në arsim ose në programe tjera si pjesë e planifikuar e regjimit, gjatë orarit të punës, ata duhet shpërblyer sikur të kishin punuar.

181. Të dënuarit duhet të marrin sigurim adekuat social ngjashëm me atë që jepet në shoqërinë e lirë.

182. Femrat kanë të drejtë të mos punojnë gjatë shtatzënisë, lëhonisë ose për shkak të lindjes në pajtim me parimet e punës.

### C, Kontakti me botën e jashtme

183. Të burgosurit duhet lejuar të komunikojnë përmes letrave, pa kufizim sa i përket numrit të tyre dhe sa më shpesh që është e mundur përmes telefonit apo formave tjera të komunikimit me familjet e tyre, persona tjerë dhe përfaqësues të organizatave të jashtme dhe të presin vizita nga këta persona.

184. Të burgosurit e huaj, të cilëve familja dhe shokët janë jashtë këtij shteti, pritet që të kenë mundësi ekstra dhe më me fleksibilitet për të bërë telefonata.

185. Komunikimi dhe vizitat mund të jenë subjekt kufizimi dhe monitorimi kur është e nevojshme për çështje sigurie por çdo herë duhet të lejohet një minimum i pranueshëm i kontaktit.

186. Të burgosurit duhet të kenë mundësinë marrjes pjesë në zgjedhje, referendume dhe në aspekte tjera të jetës publike për aq sa e drejta e tyre nuk kufizohet me ligjet vendore.

187. Të burgosurit lejohen të komunikojnë me mediat. Përjashtim bëjnë rastet kur është në pyetje çështja e sigurisë, interesi publik ose që të mbrohet integriteti i viktimave, i të burgosurve tjerë ose i personelit të burgut.

#### **D. Aktivitetet religjioze**

188. Regjimi i burgut duhet të organizohet, për aq sa është e mundshme, t'iu lejojë të burgosurit ta ushtrojnë fenë e tyre, të marrin pjesë në shërbimet religjioze dhe ngjarjet tjera religjioze të udhëhequra nga përfaqësuesit e aprovuar të atij religjioni apo besimi, të pranojnë vizita private nga përfaqësuesit e tillë dhe të posedojnë libra apo literaturë në lidhje me religjionin apo besimin e tyre

#### **E. Terapja olapuese**

189. Kjo terapi ka për qëllim t'iu ndihmojë të burgosurve që të risë pavarësinë e tyre funksionale gjatë jetës së përditshme përdërisa parandalon apo minimizon paaftësinë që sjell institucioni nga ana e vet.

#### **F. Terapja individuale dhe grupore**

190. Ka për qëllim zhvillimin e të dënuarve në aspektin emocional, social, edukues dhe për zgjidhjen e problemeve personale.

#### **G. Edukimi fizik dhe sporti**

191. Sporti dhe aktivitetet rekreative iu mundësohen të burgosurve që të ndihmojnë në uljen e stresit dhe dhunës përbrenda institucionit. Këto aktivitete janë të dizajnuara që të promovojnë një mënyrë të jetës së shëndoshë dhe me qëllim të uljes së shpenzimeve mjekësore. Që të inkurajojnë shkathtësi pozitive sociale, institucionet korrektuese ofrojnë sporte në grupe përdërisa sportet me ushtrime ofrojnë qëllimin që i burgosuri të zhvillojë një imazh pozitiv për vetveten.

#### **H. Aktivitetet e lira kreative dhe hobi**

192. Këto aktivitete duhet të jepen në të gjitha institucionet për mirëqenien fizike dhe mentale të të burgosurve. Aktivitetet kulturore dhe kreative kanë rol të madh dhe potencial që iu mundëson të burgosurve ta zhvillojnë dhe shprehin vetveten.

#### **I. Lojrat dirigjuese**

193. Nëse lojrat dirigjuese janë të lejueshme si privilegj shtesë, ato nuk duhet dhënë nga shpenzimet publike dhe vetëm për të burgosurit në regjim të avancuar. Disa lojna janë me mundësi çif-çif, e kjo është, se ato mund të përdoren për qasje në internet që nuk ka mbrojtje. Rregulla e thjeshtë është se as një lojë dirigjuese me mundësi çif-çif nuk duhet të lejohet në burg.

#### **J. Aktivitetet jashtë institucionit në komunitet, pushimet ditore dhe format tjera të pushimit**


194. Këto aktivitete dhe beneficione mund t'ri ripërtërijnë marrëdhëniet familjare dhe shoqërore e që do t'iu mundësojë atyre që të përshtaten më lehtë kur të lirohen në komunitet.

Involvimi i të burgosurve në këto aktivitete të jashtme është çdo herë i bazuar në sajë të vlerësimit të rrezikshmërisë së personit të dënuar.

**K. Përgatitja për lirim dhe përkujdesia pas lirimit**

195. Qëllimi primar i programeve paralizuese është përgatitja e të burgosurve për një re integrim të suksesshëm në shoqëri me lirin e tyre. Aktivitetet dhe shërbimet e institucionit janë të dizajnuara që të përmirësojnë çështjen e punësimit të të burgosurve, shkathhtësitë e raporteve sociale dhe njerëzore me qëllim që të implementohet një re integrim i suksesshëm në bashkëpunim me institucionet relevante dhe agjensionet e jashtme.

Nëntor 2012

Drejtor i Përgjithshëm  
Shërbimi Korrektues i Kosovës  
  
Resmi Hoxha



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Shërbimi Korrektues i Kosovës / Korektivna Sluzba Kosova / Kosovo Correctional Service  
Drejtoria Qendrore - Prishtinë

Prishtinë

Datë: 30/05/2018.

Në mbështetje, neni 215 pika 3 të Ligjit nr.04/L-149, për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe sipas propozimit të Drejtorit të Qendrës Korrektuese në Dubravë, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues, merr këtë:

#### V E N D I M

Për Ndryshimin dhe Plotësimin e pikës 80 Regjimev për të dënuar

I. Ndryshohet dhe plotësohet pika 80 e Regjimev për të dënuar me Nr.protokolli. 2415, datë 18.10.2012, dhe riformulohet si në vijim:

Të dënuarit të cilët janë shfrytëzues të pushimit jashtë institucionit korrektues dhe që pjesa e mbetur e dënimit të tyre nuk i kalon 5 vite, pas vlerësimit dhe rekomandimit të ekipit multidisiplinar, me vendimit të Drejtorit të Institucionit mund të vendosen në pavijonin gjysmë të hapur.

II. Obligohet Qendra Korrektuese Dubravë për zbatimin e këtij vendimi.

IV. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

#### Arsyetim

Pas shqyrtimit të propozimit të Drejtorit të Qendrës Korrektuese në Dubravë, duke marr parasysh se akti për regjimet e të dënuarve është në zbatim që nga viti 2012 dhe pas paraqitjes së rrethanave të reja është vlerësuar e nevojshëm që të ndryshohet ky akt me qëllim të lehtësimit të zbatimit të programeve për risocializimin e personave të dënuar, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Z. Nehat Thaçi  
Drejtor i Përgjithshëm  
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Vendimi ju dërgohet:  
Qendrës Korrektuese Dubravë  
Arkivit të Shërbimit Korrektues të Kosovës